



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1833/1 Prot.

Tiranë, më 28.12.2017

VENDIM

Nr.246, datë 28.12.2012

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT VENDIMIT NR. 137,
DATË 22.06.2017, NË INSTITUCIONIN E MINISTRISË SË ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 137, datë 22.06.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë në datën 19.6.2017, nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, *****, në lidhje me pezullimin e tij nga shërbimi civil.”

KONSTATOVA SE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

Me Urdhrin nr. 1137/1 prot., datë 19.06.2017, të Komisionerit, “Për verifikimin e informacionit të marrë në datën 19.6.2017, nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, *****, në lidhje me pezullimin e tij nga shërbimi civil” është nisur verifikimi i këtij rasti. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 137, datë 22.06.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë në datën 19.6.2017, nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse në

*Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, ******, në lidhje me pezullimin e tij nga shërbimi civil”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. *Të kërkoj nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, Urdhrin nr. 335, datë 16.06.2017, “Për pezullimin nga detyra të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit”, të nxjerrë prej tij, si dhe të anulojë çdo akt administrativ që ka dalë në bazë dhe për zbatim të këtij akti.*
2. *Të rikthejë në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimeve Mbështetëse të institucionit, punonjës in *****.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmëruar nr. 137, datë 22.06.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë në datën 19.6.2017, nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, *****”, në lidhje me pezullimin e tij nga shërbimi civil”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Enkelejda Hebibasi, Drejtor i Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe Helga Peti, Specialiste në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 04.12.2017, u paraqitën pranë institucionit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 1833 prot., datë 30.11.2017, “Mbi zbatimin e Vendimit nr. 137 dt 22.06.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë në datën 19.6.2017, nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, *****”, në lidhje me pezullimin e tij nga shërbimi civil.”

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetohnin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmëruar. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore, si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqëruar që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit, është materializuar në procesverbalin e datës 04.12.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personat e kontaktit të institucionit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore, të vëna në dispozicion, rezultoi se:

Në pikat 1 dhe 2 të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit të konstatojë pavlefshmërinë absolute të Urdhrit nr. 335, datë 16.06.2017, *“Për pezullimin nga detyra të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit”*, të anulojë çdo akt tjetër administrativ që ka dalë në bazë dhe për zbatim të tij, si dhe të rikthejë në detyrë punonjësin
*****.

Nga komunikimi me Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimeve Mbështetëse, ***** , grupi i punës u informua se ai ka vazhduar të kryejë detyrën pa u shkëputur për asnjë moment pavarësisht urdhrin për pezullimin e tij nga detyra.

Nga ana tjetër, Ministria e Arsimit dhe Sportit me Urdhrin nr. 437, datë 26.09.2017, ka konstatuar si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm Urdhrin nr.335, datë 19.06.2017, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, *“Për pezullimin nga detyra të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit”*, në përputhje me përcaktimet e neneve 108 dhe 110, 111 të Kodit të Procedurave Administrative dhe rekomandimet e Komisionerit në vendimin paralajmërues.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrës së lënë në Vendimin Nr.137, datë 22.06.2017, *“Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë në datën 19.6.2017, nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, ***** , në lidhje me pezullimin e tij nga shërbimi civil”*, të Komisionerit, rezulton se nga ana e institucionit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë janë zbatuar plotësisht të gjitha rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 137, datë, 22.06.2017, *“Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë në datën 19.6.2017, nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, ***** , në lidhje me pezullimin e tij nga shërbimi civil”*
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 137 datë 22.06.2017.

3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Departamentit të Administratës Publike dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha